



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2918 / Prot.

Tiranë më 01.11.2022

VENDIM

Nr. 29, datë 31.10.2022

“Për riorganizimin e programit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Pedagogji e Specializuar Sociale”, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të UT-së, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, gërma “B”, i ndryshuar, Udhëzimin e MASR-së Nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2, i ndryshuar dhe Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërmat f), j) dhe cc); si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave Sociale me shkresën nr. 1211 prot., datë 28.10.2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 31.10.2022;

VENDOSI:

1. Të riorganizojë programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Pedagogji e Specializuar Sociale” (Arsim Special) nga 60 kredite në 120 kredite, në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, sipas dokumentacionit bashkëlidhur, për vitin akademik 2023-2024.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Pedagogji e Specializuar Sociale” (Arsim Special) nga 60 kredite në 120 kredite në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës ngarkohet në platformën e-Albania për miratim të mëtejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Dokumentacioni përkatës përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha
UNIVERSITETI I TIRANËS